

MYSLIMANËT NË EUROPË ELEMENT MIRËKUPTIMI DHE PROGRESI

Islami (në arabisht: اسلام) është një fe monoteiste, e dyta në botë për nga numri i besimtarëve, fill pas krishtëritimit. Domethënia e fjalës “islam” është “paqe”, “bindje, nënshtrim” ndaj Allahut, Krijuesit të gjithçkaje. Islami u themelua në shekullin VII në Gadishullin Arabik, në territorin e sotëm të Arabisë Saudite nga Profeti Muhamed dhe u bazua në tekstin fetar që njihet me emrin “Kuran”. Me kalimin e kohës, islami u përhap në territore të gjera, nga Europa, në Azi dhe në Afrikën e Veriut. Qendra fetare ndodhet në qytetet e shenjta Mekë dhe Medinë. Myslimanët mendojnë se islami është mesazhi i fundit i perëndishëm dhe Muhamedi është profeti i fundit e lajmëtar i Allahut. Myslimanët besojnë edhe ekzistencën e të gjithë profetëve dhe apostujve që janë dërguar për njerëzimin para Profetit Muhamed, si: Abrahami (Ibrahimi), Josifi (Jusufi), Moisiu (Musai), Jezusi (Isai) dhe plot të tjerë që janë përmendur në Kuran; besojnë edhe në shkrimet e tyre, përfshi mesazhet që ua ka dhënë Allahu atyre për t’ua shpjeguar njerëzve, si: Tora, Psalmet dhe Ungjilli.

Shumica e myslimanëve (rreth 75-90%) janë sunitë. Konfesionit i dytë, shiitët, përbëjnë afro 10-20 %. Vendi me popullsi më të madhe myslimane është Indonezia me 12,7% të myslimanëve të botës, e pasuar nga Pakistani me 11%, India me 10,9% dhe Bangladeshi me 9,2%. Bashkësi të mëdha myslimane gjenden edhe në Kinë, Rusi e pjesërisht në Europë. Me 1, 57-1,65 miliardë besimtarë, ose 22-24% të popullsisë së globit, islami është feja e dytë me rritjen më të shpejtë të ithtarëve në botë.

Rreth vitit 610, Profeti Muhamed pati vegimin e parë hyjnor. Një shekull më pas prania e islamit në Lindjen e Mesme, në Europë, në Afrikë e në Azi la gjurmë të thella mbi viset e pushtuara. Deri më 1450 përmasat e botës myslimane ishin të konturuara mirë. Historianët janë në një mendje lidhur me faktin që kjo përhapje e shpejtë në një territor gjeografik kaq të gjerë ishte fryt i një

gërshetimi ndërmjet hapjes kulturore, pushtimit me armë dhe grishjes nga ideologjia islame e mirëfilltë.

Fakti që të gjithë europianët janë të krishterë dhe që të gjithë të krishterët janë europianë, është një paragjykim. Mjaft të kujtojmë që një pjesë e madhe e tyre janë rritur dhe edukuar në shoqërinë komuniste, e cila e mohonte Krishtin duke u imponuar atyre frymën ateiste. Përveç sa thamë, ka edhe kategori të tjera europianësh, të cilët janë pjesëtarë të një feje çfarëdo, por nuk e njohin Zotin dhe nuk e praktikojnë përluljen ndaj tij. Fakt është që kryqëzatat përbëjnë një dëshmi të urrejtjes së të krishterëve ndaj myslimanëve, megjithëse orvaten të përlligjen si kundërpërgjigje ndaj prishjes prej myslimanëve të mijëra kishave në Afrikën e Veriut e në Lindjen e Mesme. Mësymja e myslimanëve u ndal në Francë, ndërsa më pas në portat e Vjenës. Kjo është e vërteta historike. Por, rëndësi ka që të krishterët dhe myslimanët kanë të përbashkëta mjaft gjëra, që i pohojnë, i pranojnë dhe u shërbejnë si pikënisje për t'u mirëkuptuar, për bisedime konstruktive:

1. Ekziston vetëm një Zot (Krijues dhe mbrojtës i gjithçkaje);
2. E vërteta është objektive, e dukshme dhe e disponueshme për të gjithë njerëzit;
3. Moisiu, Jezusi dhe Muhamedi kanë qenë personazhe historike, reale;
4. Njerëzve u është kërkuar të respektojnë ligjin moral ashtu siç ua do zemra dhe vetëdija;
5. Zoti u dha njerëzve ligjin (Torën, Psalmet, Ungjillin, Kuranin);
6. Zoti është i madh;
7. Zoti është Krijuesi që i mëshiron njerëzit;
8. Zoti i Kuranit (Allahu) është një Zot i arsyeshme dhe jo i rastësive, as i mlllefeve.

Megjithëse myslimanët e cilësojnë Krishtin vetëm një profet të madh, pra jo edhe bir të Zotit, disa versete të Kuranit e konfirmojnë në fakt karakterin e mrekullishëm të Jezusit.

Në vazhdim po paraqesim çka thuhet në disa sure të Kuranit.

Në suren 3: 45-47: Jezusi u lind nga virgjëresha Marie;

Surja 19-19: Jezusi pati një jetë pa mëkate;

Surja 3:45: Jezusi është fjalë e Zotit,

Sura 3:49: Jezusi kreu shumë mrekulli, si p.sh.: dhënien e

dritës së syve një të verbri, shërimin e leprozëve, madje edhe ringjalljen e një të vdekuri.

Por, në rast se do ta pranonin si zot Krishtin, myslimanët do të bënin një “mëkat të pafalshëm” ose shirk.

Muhamedi (Kuran, 7:158) u ka kërkuar njerëzve ta ndjekin, pra t’ia përqafojnë doktrinën. Fill paskëtaj, në një verset, Kurani ka dëshmuar se Jezusi gjendet ndërmjet më të afërtëve të Zotit dhe se ishte i ndershëm (pra i nderuar), si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër (Kuran, 3:45).

Ndërkaq, Kurani, me çiltërsinë që e karakterizon katërcipërisht, në mjaft pasazhe thekson se Muhamedi u këshillua të kërkonte ndjesë për gabimet që pati bërë (suret 40:55, 47:19, 48:1-2) dhe që asnjë gjallesë/krijesë nuk do të ekzistonte më në botë, po që se Zoti do t’i kishte ndëshkuar për të metat e mangësitë e tyre. Aty lexojmë gjithashtu se një nga fitoret ushtarake të Muhamedit i shërbeu për t’u siguruar për faljen e mëkateve të veta, në të shkuarën e në të ardhmen.

Në Kuran (2:253, 3:45-49, 4:158, 171, 5:49, 19:33, 89:22) bie në sy fakti që Krishti është quajtur “Mesia”, që është lindur nga Virgjëresha, që bën pjesë ndër të panjollët dhe ndër më të afërtit e Zotit. Po ashtu theksohet që mori mbështetje nga Shpirti i Shenjtërisë, që bëri tërë ato mrekulli që i përmendëm më sipër dhe që u quajt “Fjalë e Zotit e Shpirt prej Tij”. Po aty thuhet edhe se ai (Jezusi) do të kthehet sërish në botë para Ditës së Gjykimit.

Të gjitha këto përshkrime nxjerrin në pah një shëmbëlltëri të qartë të një Krishti si profet i përkryer.

Përhapja e islamit u krye sipas dy modeleve. Në disa raste kontakti ndërmjet islamit dhe kulturave të tjera u mishërua në rrugë të armatosur, megjithëse feja myslimane ka qenë qysh në fillim e sot e kësaj dite tolerante ndaj feve të tjera. Tepër rrallë, myslimanët i detyronin njerëzit të konvertoheshin në fenë e tyre. I mirënjohuri Xihad apo Lufta e Shenjtë, që është përshkruar nga vetë Profeti Muhamed, përdorej në radhë të parë për të mbrojtur besimin fetar. Megjithatë, ndodhte që të përfitohej nga pushtimet e territoreve për ta nxitur popullin përkatës në konvertim.

Por, në përgjithësi, konvertimi bëhej në mënyrë spontane. Njerëzit njiheshin me fenë myslimane gjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare dhe misionarizmit. Feja islame ishte

tërheqëse, sepse shpaloste mjaft këshilla për një jetë të bukur, në radhë të parë këtu, në tokë.

Duke pasur parasysh që rënia e Perandorisë Romake shkaktoi rrëmuje në shtetet e Mesdheut Lindor dhe konfuzion të plotë ndër të krishterët dhe hebrejtë, Profeti Muhamed jo vetëm shpalli vullnetin për ta riorganizuar kulturën arabe, por edhe shpalli një fe e cila synonte dhe dëshironte ta bënte të përkryer mendimin e besimeve fetare të deriatëhershme. Islami përfaqësonte një sistem monoteist serioz, që mbronte disa parime, të cilat do ta shpëtonin botën arabe.

Sukseset e i në Afrikë dhe Azi ngjallën frikë dhe urrejtje në radhë të të krishterëve fanatikë në Europë, të cilët po e shikonin islamin si rival e kundërshtar të rrezikshëm. Luftrat kundër myslimanëve apo kryqëzatat, siç u quajtën në shekullin XI, synonin para së gjithash ripushtimin e Tokës së Shenjtë, siç e patën pagëzuar ata.

Kontakti i islamit me Europën u mishërua në dy trajta: përmes shkëmbimeve kulturore dhe me anën e grupit të myslimanëve aktivë që hodhën rrënjë deri në ditët tona në kontinentin plak. Në periudhën kur arabët e zgjeruan horizontin drejt Europës, Gadishulli Iberik prej dyqind vjetësh qeverisej nga fisi gjermanik i vizigotëve. Pasanikët vendës u kërkuan ndihmë myslimanëve dhe këta nuk vonuan t'ua jepnin. Duke ardhur nga territoret e sapopushtuara të Afrikës së Veriut, gjenerali mysliman Tarik bin Zijad e mposhti mbretin vizigot Roderik. Kësisoj arabët, brenda tre vjetësh morën frenat e drejtimit të krejt Gadishullit Iberik. Banorët e këtij të fundit i pritën arabët krahëhapur dhe shumica u konvertuan me dëshirë në fenë islame. Gjithashtu, arabët donin të bënin paqe me vizigotët me mirëkuptim të ndërsjellë, duke mos ua mohuar lirinë.

Stili arab ndikoi për një kohë të gjatë në arkitekturë e në dizajn, edhe pasi arabët u larguan nga Europa Perëndimore. Edhe në muzikë arabët lanë gjurmë. Spanjollët, bie fjala, morën kitarën – vegël arabe, duke krijuar stile të reja, që u përvetësuan më pas edhe nga Amerika.

Qendra studimore si ajo në Toledo, përgatitën intelektualë që u përhapën në krejt Europën dhe që patën në themel shkencën dhe filozofinë e sjellë nga myslimanët.

Megjithë këto të mira të mëdha, kryqtarët e Spanjës Veriore ngulnin këmbë të rimerrnin territoret e humbura. Të krishterët fanatikë nuk e lanë ndikimin arab të depërtonte edhe në pjesët e tjera të kontinentit plak. Tërheqja e arabëve ishte masive, dhe më 1492, të fundmit e mbetur në Granadë u dëbuan nga pushteti monarkik i Fredinandit dhe Izabelës. Ndërkohë myslimanët u përpoqën të riktheheshin në Europë, këtë herë përmes Ballkanit. Perandoria Otomane, tashmë një nga më të fuqishmet, bëri që myslimanët të pushtonin pjesën lindore të Europës për ta sunduar disa shekuj. Sa më shumë fuqizohej kjo perandori, aq më shumë rritej numri i njerëzve që përqafonin fenë islame.

Në shekullin XVII, kur Perandoria Otomane po rrënohej, konvertimi në islam praktikisht u ndal.

Islami sot është feja e dytë më e madhe e praktikuar në Europë. Deri një dekadë më parë bashkësia islame në kontinentin plak u dyfishua duke arritur në 15-20 milionë besimtarë⁽¹⁾. Sipas të njëjtit autor, myslimanët në vitin 2005 në Francë ishin 6 milionë, në Gjermani 4 milionë, në Itali 1 milion, në Britaninë e Madhe 2 milionë, në Spanjë 1 milion, në Holandë 1 milion etj.

Në ndryshim nga ata të Europës Perëndimore dhe të SHBA-së, myslimanët e Europës Lindore janë më të shumtët vendës. Këtu, përsëri për vitin 2005, statistikat tregojnë për numrin e myslimanëve si më poshtë: në Rusi 21 milionë, në Bullgari 3 milionë, në Bosnjë 2,5 milionë, në Kosovë 2 milionë, në Ukrainë 2 milionë, në Serbi 800 mijë, në Shqipëri 2 milionë, në Rumani 120 mijë etj.

Në bashkësitë myslimane të Europës lindshmëria është tri herë më e lartë se sa në vendet pritëse të emigrantëve myslimanë. Numri i këtyre të fundit më 2015-n parashikohej të dyfishohej.⁽²⁾ Pjesa më e madhe e myslimanëve erdhën në Europën Perëndimore në vitet '50-'60 të shekullit të kaluar, kur ndjehej nevojë e madhe për fuqi punëtore. Ata erdhën familjarisht, kryesisht nga Turqia, Algjeria, Tunizia, Maroku dhe Pakistani.

Pavarësisht nga dallimet etnike dhe kulturore, apo përkatësisë

¹ Shih: Ross Douthat, "A Muslim Europe?", në "The Atlantic Monthly", janar 2005, f. 58.

² Sipas: Omer Taspinar, Europeas Muslim Street, Foreign 135, mars-prill 2003, f. 77.

në shkolla sektesh të ndryshme fetare, të gjithë myslimanët e Europës përbëjnë një entitet të vetëm fetar, të lidhur përmes vëllazërimit. Nga ana tjetër, në të gjitha vendet europiane ata i përkasin edhe shtetit ku kanë shkuar për të jetuar e punuar. Çdo diskriminim që mund të shfaqet mes tyre për shkak të zanafillës etnike cilësohet si një dukuri që bie ndesh me vlerat islamike, të cilat e vënë fort theksin tek uniteti i besimtarëve myslimanë. Në bazë të parimeve fetare dhe interesave të përbashkëta jetike, myslimanët e Europës janë të prirur të takohen, të bashkëpunojnë dhe t'i bashkërendojnë përpjekjet vetjake dhe të institucioneve të tyre. Myslimanët e Europës respektojnë ligjet e vendeve ku kanë mërguar si dhe autoritetet, të cilat kërkojnë zbatimin e tyre.⁽³⁾

Kjo nuk do të thotë që njëherazi myslimanët të mos mbrojnë të drejtat individuale dhe kolektive kur u shkelen, apo të shfaqin mendime për mbarëvajtjen e punëve në kuadrin e bashkësive fetare islamike ose të çdo natyre tjetër. Atje ku mund të nxjerrë krye ndonjë mosmarrëveshje që ka lidhje me ligje të caktuara apo me aspekte që janë specifike për fenë, shtrohet problemi që në bashkëveprim me autoritetet shtetërore vendore apo kombëtare keqkuptimet të zgjidhen drejt e në kohë, gjithnjë në rrugë demokratike. Myslimanët e Europës respektojnë parimin e asnjësisë së shtetit ndaj çështjeve fetare. Thënë ndryshe: respektojnë të gjitha fetë dhe u japin mundësi besimtarëve ta shprehin besimin dhe të vënë në zbatim praktikatat fetare përkatëse si individë dhe në grupe, në përputhje me kartat dhe marrëveshjet europiane të të drejtave të njeriut.⁽⁴⁾

Në këtë kontekst, myslimanët gëzojnë të drejtën të ndërtojnë xhami dhe institucione fetare, arsimore, kulturore dhe të ndihmës sociale; ta praktikojnë fenë në jetën e përditshme, si në ushqim e veshmbathje, ashtu edhe në aspekte të tjera. Si qytetarë europianë, myslimanët e Europës e quajnë për detyrë të punojnë për të mirën e shoqërisë, të luajnë rol aktiv në jetën e shoqërisë dhe njëherazi ndershmëria e zelli t'u shpërblehen nga shoqëria ashtu siç e meritojnë.⁽⁵⁾

³ Walter Martin, *The Kingdom of the Kults*, Betany House Publishers, Mineapolis, Minnesota, 55 438, 1985.

⁴ Josh McDowell, *A Ready Defense*, Here's Life Publishers, 1990.

⁵ *The Christian Research Journal*, verë, 1993.

Feja islame ka rregulla të forta që respektohen nga besimtarët e mirëfilltë. Rëndësia e martesës në traditën myslimane, dobia e shoqërisë, mbështetet kryesisht në gjendjen shpirtërore të individit dhe në lumturinë e çiftit. Nga ky këndvështrim martesë përfaqëson një shtyllë me peshë të veçantë në lidhjen burrë-grua, si dhe një shenjë mençurie. “Ai ju krijoi bashkëshortë që të rroni të qetë. Po ai u dha dashuri e durim dhe këto janë tregues për një bashkësi njerëzish që arsyetojnë” (Kuran, 30:21). Në fenë myslimane theksohet se “Allahu është i vetmi Zot”; Kurani, libri i shenjtë i fesë myslimane vë në dukje se Allahu është ai që e krijoi njeriun nga një mpiksje gjaku (sure 96:2). Kësisoj njerëzit janë ngjizur me vullnet të lirë, hyjnor, me qëllim që ta dëgjojnë dhe t’i shërbejnë Zotit të vetëm. Feja myslimane kërkon nga besimtarët e saj t’i falen Allahut pesë herë në ditë, të agjërojnë në muajin e Ramazanit dhe, në rast se gjendja financiare ua mundëson, të shkojnë për pelegrinazh (haxhillëk) në Mekë të paktën një herë në jetë. Bujaria, zemërgjerësia, është një tjetër rregull i rëndësishëm i islamit, që thotë se një mysliman duhet të kryejë veprime bamirësie =do vit. Gjithashtu, Kurani tërheq vëmendjen që vlera e dhuratës për të vobektët duhet të jetë në përpjesëtim të drejtë me pasurinë e grumbulluar.⁽⁶⁾

Nga ana tjetër, Xhihadi, e ritheksojmë, para së gjithash, ka në qendër të kujdesit një luftë të brendshme për ngadhënjimin e gjithanshëm të së mirës dhe zhdukjen e padrejtësive sociale. Pra, nuk ka të bëjë as për nga larg me ekstremistët islamikë, që duke e quajtur “Luftë e Shenjtë” e keqpërdorin për qëllime të mbrapshta. I vetmi aspekt “luftarak” i mundshëm i termit “Xhihad” mund të kuptohet kryekëput si luftë kundër agresionit e tiranisë. Vlen të theksojmë se islami hedh poshtë çdo formë terrori, ekstremizmi apo fanatizmi. Kjo është e vetvetishme, përderisa feja myslimane e vlerëson lart jetën e njeriut. Është keqdashje ta quash islamin sinonim të terrorizmit. Terrorizmi (si, p.sh., ISIS-i) nuk ka të bëjë fare me fenë, por me lakminë për pushtet të disa të çekuilibruarve që e përdorin fenë thjesht si pretekst.⁽⁷⁾

⁶ John Ankerberg & John Weldon, *The Facts on Jesus the Messiah*, Harvest House Publishers, 1993.

⁷ Don McCurry, “Witnessing to Muslims”, pjesa 2; *Lecture on Islam* /dimër, 1994.

Kjo ndodh njëloj si atëherë kur kryqtarët plaçkitnin dhe vrisnin këdo që iu dilte përpara, pa mbajtuar parasysh nëse ishin apo jo të krishterë. I vetmi ndryshim është se tani ISIS-i ka armë shumë më të fuqishme e moderne dhe mënyra tepër më të shpejta për zbatimin e terrorit në krahasim me kryqtarët. Mungesa e arsimit dhe e kulturës përbën shkakun kryesor që njerëz të ndryshëm ndikohen kaq lehtë nga ata.

Në mbyllje përsërisim një të vërtetë të njohur e të mbarëpranuar: mjafton shembulli i Shqipërisë gjatë shekujve për të treguar botërisht vlerën e padiskutueshme të islamit, si fe e paqes dhe e mirëkuptimit me fetë e tjera bashkëjetuese.